

## **Komuna e Shtimes: problemet kryesore dhe trendët buxhetor**

### **Hyrje**

1. Komuna e Shtimes udhëhiqet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kryetari i saj është Naim Ismajli, i cili është rizgjedhur në mandatin e dytë në zgjedhjet lokale të vitit 2009.
2. Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës. Sipas rezultateve nga regjistrimi i fundit i popullsisë më 2011, kjo komunë ka 27.288 banorë.<sup>1</sup> Shtimja është udhëkryq i rrugëve regjionale, gjë që ndikon pozitivisht në zhvillimin bizneseve të kësaj komune.
3. Komuna e Shtimes ka shtatë drejtori dhe numëron 21 asambleistë në Kuvendin Komunal. PDK udhëheq me 10 asambleistë, pastaj vjen LDK me pesë asambleistë, AKR me dy, LDD me dy, dhe AAK e PSD me nga një asambleist.
4. Në bazë të hulumtimit të opinionit të qytetarëve nëpër komunat e vendit i realizuar nga UNDP i përmbledhur në raportin “Mozaiku i Kosovës”, 78% e banorëve të Shtimes konsiderojnë se problemet në lagjen dhe komunën e tyre mund të zgjidhen nga pushteti lokal, ndërsa vetëm 8% e banorëve të kësaj ane konsiderojnë se ato probleme mund të zgjidhen vetëm nga niveli qendror.<sup>2</sup>
5. Në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2009, problemet kryesore në atë kohë në këtë komunë kanë qenë mungesa e ujit, mungesa e çerdhes publike, mungesa e stacionit për autobusët, mungesa e qendrës së zjarrfikëseve si dhe mungesa e aktiviteteve rinore dhe qendrës rinore.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Fq 134. Burimi: [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)

<sup>2</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 146. Burimi: [http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Alb\\_216\\_825.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf)

<sup>3</sup> Instituti GAP. Raporti komunal. Komuna e Shtimes. 2009. Fq 3. Burimi: [http://www.institutigap.org/documents/48518\\_Shtime-raporti%20komunal.pdf](http://www.institutigap.org/documents/48518_Shtime-raporti%20komunal.pdf)

## Problemet kryesore të Komunës së Shtimes 2013

- 1. Mungesa e kanalizimeve.** Disa nga fshatrat malor në Shtime kanë mungesë të rrjetit të kanalizimit, ndërsa në disa fshatra të rrafshit ky rrjet është pjesërisht i instaluar. Fshatrat malor që përballen me mungesë të këtij rrjeti të kanalizimit janë: Dugë, Rancë, Karaqicë, Llanishtë, Topillë dhe Davidoc. Ndërsa fshatrat e tjerë që pjesërisht e kanë të përfunduar rrjetin e kanalizimit janë Pjetërshicë, Gjyrkovc dhe Rashincë. Brenda qytetit të Shtimes, kanalizimet gjatë të reshurave nuk mund të pranojnë sasinë e ujit duke shkaktuar kështu probleme për këmbësoret dhe ngasësit e automjeteve. Në hulumtimin e opinionit të qytetarëve nga ana e organizatës USAID/DEMI, 37% e qytetarëve në Shtime janë shprehur të pakënaqur me gjendjen e kanalizimeve në vendbanimet e tyre.<sup>4</sup>
- 2. Mungesa e ndriçimit publik.** Në Shtime ndriçimi publik është transferuar në panele solare por që nuk është i pranishëm në të gjitha zonat e qytetit dhe në periferi. Në rrugët “Adem Jashari”, “Tahir Sinani” dhe “Komandant Kumanova” ka ndriçim publik ndërsa disa rrugë tjera nuk kanë, si p.sh rruga “Ismail Qemajli” e cila rrugë edhe frekuentohet shumë nga nxënësit e shkollave të kësaj ane. Fshatrat përreth nuk kanë ndriçim publik në përjashtim të fshatit Reçak ku ka pjesërisht ndriçim. Fshatrat Davidoc, Godanc, dhe Petrovë kanë kërkuar nga autoritetet komunale që t’ua rregullojnë ndriçimin publik por që ende nuk është parë një investim nga ana e Komunës. Në hulumtimin e USAID/DEMI, 48% e qytetarëve në Shtime janë shprehur të pakënaqur me gjendjen në vendbanimet te tyre për sa i takon ndriçimit publik.<sup>5</sup>
- 3. Prezenca e gurëthyesve.** Në zonën përreth Shtimes, konkretisht në fshatin Petrovë, ekzistojnë gjashtë gurthyes. Banorët e këtij fshatin përballen me ndotje të madhe të ajrit nga prezenca e pluhurit. Banorët e këtij fshati kanë protestuar dy here para Komunës se Shtimes duke kërkuar largimin e gurthyesve nga fshati i tyre me aludimin se shtëpitë e tyre u rrezikohet shembja nga detonimet e fuqishme që shkaktojnë kohë pas kohe kompanitë e gurthyesve. Këta banorë rrezik kanë vlerësuar edhe nga lëvizja e mundshme e dheut në vendbanimet e tyre. Për veç fshatit Petrovë edhe në fshatin Reçak ekzistojnë dy gurthyes.

<sup>4</sup> Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 23. Burimi: [http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen\\_Satisfaction\\_Report-Shqip.pdf](http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf)

<sup>5</sup> Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 41. Burimi: [http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen\\_Satisfaction\\_Report-Shqip.pdf](http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf)

- 4. Mungesa e stacionit të autobusëve dhe vend ndaljes së autobusëve.** Komuna e Shtimes ende nuk ka arritur të ndërtojë stacion të autobusëve. Për veç kësaj, në territorin e kësaj komune nuk hasen të rregulluara vend ndaljet për autobus dhe as kabinat për pritjen e autobusëve. Kësisoj autobusët në këtë qytetës ndalen në vendet të ndryshme, ndërsa udhëtarët presin në hapësira të hapura edhe në kushte jo të përshtatshme klimatike.
- 5. Mosmirëmbajtja e lumit “Shtimjana”.** Shtrati i këtij lumi është rregulluar pjesërisht por që nuk mirëmbahet. Ky shtrat është shndërruar në hapësirë për hedhjen e mbeturinave. Gjithashtu, në këtë lum derdhen edhe ujërat e zeza, gjë që po ndikon në ndotjen e ujit dhe njëkohësisht po ndikon edhe negativisht në pamjen e qytetit.
- 6. Mungesa e përkrahjes institucionale të klubeve sportive.** Klubi i Karatesë, Klubi i Boksit, Klubi i Shahut dhe i Futbollit të vogël i kanë shuar veprimtarinë e tyre në Komunën e Shtimes, shkaku i mungesës së objekteve për ushtrimin e veprimtarisë, por edhe të mundësisë së përkrahjes institucionale ndaj tyre.

## Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur dhe ruajtur


- 1. Mbrojtja e Kështjellës mesjetare dhe e shpellës së mermerit në Topillë.** Kështjella mesjetare e Topillës, e cila njihet si “Guri i Shtrenjtë”, gjendet mbi një shkëmb në një ngushticë 10 km në jug të Shtimes dhe shtrihet nëpër luginën e Topillës. Në këtë fshat është zbuluar së voni edhe një shpellë e mermerit. Qytetarët kërkojnë që Komuna ta mirëmbajë këtë lokalitet dhe të sensibilizojnë opinionin për rëndësinë e të këtyre shpellave.

## Trendet Buxhetore në Komunën e Shtimes

Komuna e Shtimes në vitin 2013 ka planifikuar 4.8 milion euro buxhet. Krahasuar me vitin 2010, komuna e Shtimes ka rritur buxhetin për 949 mijë euro (25%). Të hyrat vetanake në vitin 2012 kanë qenë 271 mijë euro, apo 63 mijë euro më pak se në vitin 2010. Struktura e këtyre të hyrave në vitin 2012 është dominuar nga të hyrat nga taksat (42%) dhe

tatimi në pronë (36%). Sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm<sup>6</sup>, kjo komunë ka arritur të mbledhë vetëm 71% të të hyrave, nga 9.300 prona të regjistruara, ku 4.100 (apo 45%) janë pagues të rregullt të tatimit në pronë.<sup>7</sup> Sfidë tjetër sa i përket të hyrave është niveli i lartë i borxheve ndaj komunës ku vetëm borxhi i tatimit në pronë arrin në 477 mijë euro.

Figure 1. Buxheti i Komunës së Shtimes 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?shtime/2013#/~/~shtime>

Në bazë të grafikonit të mëposhtëm rreth trendeve të ndarjeve buxhetore, shohim se krahasuar me vitin paraprak shpenzimet kapitale kanë pasur një rënie prej 265 mijë euro (15%) në vitin 2012.

<sup>6</sup> ZAP, Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Shtimes Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 03 Shtator 2013 [http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KSHT\\_2012\\_Shqip\\_318280.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KSHT_2012_Shqip_318280.pdf)

<sup>7</sup> Komuna e Shtimes, Përgjigje në Kërkesën e Instituti GAP. 16 Gusht 2013

Figura 2. Trendet Buxhetore 2010-2013



Në tri vitet e ardhshme, Komuna e Shtimes planifikon t'i rrisë shpenzimet në të gjitha kategoritë me rreth 4%. Rritjen më të madhe do ta ketë kategoria e “pagave dhe mëditjeve” (147 mijë euro), e përcjell nga “investimet kapitale” me rreth 67 mijë euro. Rritja e shpenzimeve planifikohet të financohet kryesisht nga rritja e grantit qeveritar.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore 2014-2016

<b>Të hyrat</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>Të hyrat totale</b>	<b>5.360.257</b>	<b>5.500.920</b>	<b>5.613.770</b>
Të hyrat vetanake	409.500	421.785	430.221
Grantet	4.950.757	5.079.135	5.183.549
<b>Shpenzimet Totale</b>	<b>5.360.257</b>	<b>5.500.920</b>	<b>5.613.770</b>
Pagat dhe Mëditjet	3.171.613	3.250.901	3.319.003
Mallrat dhe Shërbimet	586.375	601.030	613.046
Shpenzimet Komunale	157.242	161.173	164.395
Subvencionet dhe Transferet	113.540	116.468	118.795
Shpenzimet Kapitale	1.331.487	1.371.348	1.398.531

## **Metodologjia e hartimit të raportit**

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe kampanjave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës huluntuese dhe analitike, janë grumbulluar informata të respektueshme për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Shtimes është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e huluntimeve më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012), etj.



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.